



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË



ANALIZË VJETORE 2014

JANAR 2015

PËRMBAJTJA

Hyrje

Fjala e Kryetarit

Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2014

Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2014

Cilësia në Gjykim

Ngarkesa e gjyqtareve

Shpejtësia në Gjykim

Administrimi i fondeve për vitin 2014

Aktivitet qe jane zhvilluar ne vitin 2014

Hyrje

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

Të nderuar kolegë,

Kam nderin që të paraqes veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke prezantuar të gjithë aktivitetin një vjeçar. Ky dokument nuk ka për qëllim të japë thjesht të dhënat statistikore të vitit gjyqësor por përkundrazi synon të jetë një moment analize, reflektimi dhe një progres raport i cili përcakton edhe objektivat që Gjykata e Apelit Tiranë ka përcaktuar për këtë vit gjyqësor.

Legjislacioni ynë është i ri dhe në një proces intensiv pasurimi e ndryshimesh të vazhdueshme por sfida jonë më e madhe edhe këtë vit mbetet cilësia në dhënien e drejtësisë. Jam i bindur se zhvillimi i gjykimit në respektim të procesit të rregullt ligjor, i finalizuar me dhënien e një vendimi gjyqësor të bazuar në ligj dhe në prova, kërkojnë profesionalizëm dhe integritet, pikësëpari nga vetë gjyqtarët dhe më tej nga aktorët e tjerë të sistemit gjyqësor në tërësi.

Një sfidë tjetër e Gjykatës së Apelit Tiranë është rritja konstante e transparencës në gjykim dhe në publikimin e vendimeve gjyqësore. Kujtudo i garantohet e drejta dhe mundësia të dëgjojë çështjen e tij apo të tjerëve në një seancë publike, të njihet me zhvillimet e proceseve gjyqësore dhe me përmbajtjen e vendimeve të shpallura nga gjykata.

Analiza vjetore e Gjykatës së Apelit Tiranë gjatë vitit 2014, pasqyron një përmbledhje të aktiviteteve të institucionit, progresin e arritur në fusha të veçanta, problematikat e shfaqura dhe masat e marra për zgjidhjen në kohë të tyre si dhe sfidat për vitin 2015.

Gjykata e Apelit Tiranë, në veprimtarinë e saj gjatë vitit 2014, ka patur si qëllim kryesor shërbimet gjyqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës në vendet e Bashkimit European.

Në funksion të detyrës së drejtimit të një prej gjykatave më të mëdha dhe të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, politikat dhe prioritetet e Gjykatës së Apelit Tiranë, për vitin 2014, kanë qenë të orientuara drejt realizimit të objektivave kryesorë, përcaktuara si më poshtë:

Krijimin e kushteve cilësore të zhvillimit të proceseve gjyqësore, nëpërmjet mirë organizimit të aktivitetit të Gjykatës së Apelit Tiranë; përmirësimin e infrastrukturës

ndërtimore, kushteve të punës, gjykimin dhe shërbimit si dhe plotësimin me elementeve të sigurisë.

Arritja e nivelit më të lartë të transparencës të qytetarët për të gjithë veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Thjeshtimi i të gjitha procedurave për marrjen e informacionit dhe rritja e efikasitetit në dhënien e shërbimeve nga ana e Gjykatës së Apelit.

Përmirësimin në vazhdimësi të teknologjisë së informacionit në shërbim të procesit gjyqësor, me qëllim mbështetjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rritjen e shpejtësisë në shkëmbimin e informacionit, eliminimin e barrierave burokratike dhe përmirësimin e shërbimit ndaj publikut.

Mbështetjen në vazhdimësi për rritjen profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Garantimi i integritetit personal të çdo gjyqtari, zbatimin strikt të rregullave të solemnitetit në gjykim.

Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërinstucionale dhe organizimi ose pjesëmarrja në tryezave të përbashkëta, dhënia e një kontributi të rëndësishëm në procesin e reformës së sistemit të drejtësisë.

Një vendim-marrje në zbatim dhe përputhje me ligjin dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke angazhuar nëpunës të përkushtuar e me një sens të lartë ndershmërie dhe profesionalizmi.

Këto objektiva kanë për qëllim final atë të përafrimit të gjykatës së Apelit Tiranë dhe shërbimit që i ofrohet publikut, me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian në përgjithësi e me Legjislacionin e Bashkimit Evropian në veçanti.

Objektivat dhe masat e marra për ti zbatuar ato kanë gjetur mbështetje edhe në rekomandimet e Progres Raportit të BE-së, Rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe në përgjithësi në gjithë dokumentacionin studimor e konsultues të ekspertëve të huaj mbi kushtet e domosdoshme për funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Si Kryetar i Gjykatës së Apelit dhe në ushtrim të detyrës time si gjyqtar, kam pasur gjithmonë si udhërrëfyes parimin e shtetit të së drejtës, me bindjen se një gjykatë e pavarur, e paanshme, transparente është një kusht i domosdoshëm, për të rikthyer besimin e publikut në sistemin e drejtësisë shqiptare.

Më poshtë po ndalemi në aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Gjykata e Apelit Tiranë si dhe sfidat të cilat na dalin përpara për vitin 2015.

Investimet e vitit 2014, kanë krijuar mundësinë e funksionimit normal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe shërbimeve gjyqësore.

Në një periudhë kohore prej **një viti** është bërë i mundur një përmirësim i gjykatës në këto drejtime:

1.Krijimin e dhomave të këshillimit dhe mobilimin e tyre me një stil dhe standart bashkohor.

2.Krijimin dhe përdorimin e bibliotekës ligjore brenda Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilin ishim angazhuar vitin e kaluar.

3.Krijimin dhe rritjen e sigurisë dhe besimit të publikut në përballjen e parë me gjykatën. Rritjen e sigurisë së trupës gjyqësore duke ndarë fluksin gjyqtarë, prokurorë dhe administratë nga publiku dhe organet e sigurisë dhe të policisë .

4.Konsolidimin dhe eficesën e websitit të gjykatës ku çdo i interesuar merr informacion në kohë rekord.

6.Krijimin e kushteve mjaft komode për punonjësit e gjykatës duke ndikuar në rritjen dhe rendimentin e punës në gjykatë.

7. Konsolidimin e arkivit për marrjen e informacionit.

8. Krijimin e një sistemi anketues bazuar në pyetësin mbi nivelin e kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet gjyqësore.

9. Krijimin e sistemit të paraqitjes së ankesave dhe pritjes së qytetarëve.

* * *

Sic rezulton nga statistikat edhe gjatë këtij viti, Gjykata e Apelit Tiranë ka përballuar një numër më të madh çështjesh të regjistruara dhe të gjykuara në këto vitet e fundit. Sic vihet re, numri i çështjeve ka ardhur duke u rritur, e në disa raste duke u dyfishuar, në krahasim me çështjet e gjykuara në vitin 2013.


Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2014

Gjatë vitit 2014, në këtë gjykatë **kanë përfunduar me vendim përfundimtar gjithsej 8398 çështje** (nga 6066 krahasuar me vitin 2013.)

Konkretisht janë gjykuar :

- **4027 çështjescivile themeli** (nga 2724 krahasuar me vitin 2013)
- **1188 çështje penale** (nga 1201 në vitin 2013)
- **63 çështje administrative**, (nga 160 në vitin 2013)
- **1127 çështje me objektsigurim padie, rivendosje në afat etj,**
- **219 çështjedhënie fuqivendimeve të gjykatave të huaja** (nga 250 në vitin 2013)
- **1746 çështje përvleftësimin emasave të sigurimit**, (nga 902 në vitin 2013)
- **28 çështjeme objekt urdhër mbrojtje**

Më poshtë pasqyrohet një paraqitje grafike e këtyre të dhënave statistikore:




Volumi i çështjeve civile të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndara sipas rretheve, rezulton në të dhënat e mëposhtme:

EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE CIVILE SHQYRTUAR NË SHKALLË TË DYTË PËR VITIN 2014

Nr.	Gjykata e Rrethit	Çeshtjet			Perfundimi		Menyra e perfundimit						
		Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Shqyrtuar	Ne dore	Lenie ne fuqi	Prishur per rigjykim	Prishur e gjykuar ne fakt	Pushuar dhe rrezuar	Moskopesence	Ndryshuar	Ndryshuar per shkaqe te tjera
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Tirane	2689	3167	5856	3604	2252	1276	232	28	71	1726	271	187
2	Kruje	138	119	257	121	136	51	13	1	6	44	6	4
3	Kurbin	65	60	125	66	59	27	7	3	5	18	6	1
4	Diber	64	48	112	90	22	18	6	1	3	53	9	0
5	Mat	102	136	238	145	93	46	17	1	16	48	17	3
TOTALI		3058	3530	6588	4026	2562	1418	275	34	101	1889	309	195

Çështje civile të shqyrtuara gjatë vitit 2014 sipas rretheve gjyqësore




Siç vihet re nga grafiku i mësipërm rrethi gjyqësor i Tiranës ka pjesën më të madhe të volumit të çështjeve civile me 89 % të çështjeve të shqyrtuara nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë.

EVIDENCA STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE PENALE SHQYRTUAR NË SHKALLË TË DYTË PËR VITIN 2014

Gjykata e Rrethit	Çeshtjet			Përfundimi			Mënyra e përfundimit							Llojet e ndryshimeve			Afati i shqyrtimit			
	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Shqyrtuar	Ne dore	Pezulluar	Lenie ne fuqi	Prishur (pushuar)	Prishur	Kthyer per rigjykim	Kthyer per rihetim	Mospranimi ankimit	Gjykuar si shkalle e Pare	Ndryshuar	Lidhur me denimin	Rikualifikim	Padia civile	Deri ne 2 muaj	2 - 6 muaj	Mbi 6 muaj
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21
Tiranë	421	1655	2076	967	1109		677	78	19	58	1			133				64	563	340
Kurbin	23	96	119	42	77		30	3	1	2	0			7				2	23	17
Krujë	56	155	211	96	115		69	9	3	6	0			9				2	66	28
Mat	32	78	110	41	69		29	4	0	2	0			6				3	22	16
Dibër	25	87	112	42	70		28	6	0	2	0			6				1	30	11
TOTALI	557	2071	2628	1188	1440	0	833	100	23	70	1	0	0	161	0	0	0	72	704	412

Çështje penale të shqyrtuara gjatë vitit 2014 sipas rretheve gjyqësore



Cilësia në Gjykim


Në këtë kontekst një vendim gjyqësor për t'u konsideruar me cilësi të lartë, duhet të perceptohet nga palët se është rezultat i aplikimit të drejtë të ligjit, i një procesi të rregullt dhe një vlerësimi të duhur të fakteve.

Gjykata e Apelit Tiranë ka qënë mjaft e angazhuar në procesin e reformës në sistemin e drejtësisë duke zbatuar me efektivitet këto ndryshime ligjore.

Në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë kam shprehur se ka ardhur momenti që të ketë një rritje të konsiderueshme të vendim-marrjes unifikuesenga ana e Gjykatës së Lartë, pasi kjo do të ndikonte drejtëpërdrejtë në forcimin e mëtejshëm të cilësisë së gjyqimit, të Gjykatave më të ulta.

Më poshtë paraqiten disatabela dhe grafikë të cilat pasqyrojnë të dhënat statistikore lidhur me cilësinë në gjykim të Gjykatës së Apelit Tiranë për çështjet civile dhe për ato penale:

Çështje Civile, Pezullim, Rivendosje në afat, Administrative, gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, që kanë ardhur në vitin 2014 nga Gjykata e Lartë



Të dhënat e mësipërme flasin për një trend pozitiv në vendim-marrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë ku 83 % të çështjeve civile janë lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Lartë.


Cilësia e gjykimit Çështje Civile, Pezullim, Rivendosje në afat, Administrative, gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, që kanë ardhur në vitin 2014 nga Gjykata e

Lartë

GJYQTARË	Gjithsej	Lënie ne fuqi	Prishur	Ndryshuar
Alaudin Malaj	49	40	8	1
Fiqirete Mullaj	26	25	1	-
Shkelqim Miri	24	22	2	1
Zamir Poda	53	47	5	2
Illir Toska	77	66	7	4
Edlira Petri	9	7	2	-
Gramoz Levanaj	23	20	3	-
Valdete Hoxha	28	26	-	2
Flutura Skenderi	55	44	9	5
Artur Kalaja	52	43	9	-
Hysni Demiraj	41	35	4	2
Zegjine Sollaku	52	39	10	2
Edmond Gogo	24	21	3	-
Gjin Gjoni	43	34	7	2
Lefter Jahaj	-	-	-	-
Metush Saraçi	14	11	2	1
Genti Shala	17	14	2	1
Astrit Haxhialushi	-	-	-	-
Fatos Qato	17	15	2	-
Shkëlqim Mustafa	1	1	-	-
Agim Bendo	-	-	-	-
Fatmira Hajdari	-	-	-	-
Ervin Metalla	-	-	-	-
Maria Qirjazi	2	2	-	-
Ridvan Hado	-	-	-	-
Shkëlqim Mustafa	1	1	-	-
Evjeni Sinojmeri	2	2	-	-

Në këtë kuadër është imperative që krahas organizimit të një sistemi më të qartë dhe të matshëm periodikisht të vlerësimit profesional të gjyqtarëve, nxjerrja e sa më shumë vendimeve unifikuese nga ana e Gjykatës së Lartë është rruga e vetme për ta përmirësuar të gjithë sistemin e vlerësimit të punës së Gjyqtarëve.

Edhe Komisioni i Venecias, ka nënvizuar nevojën për një reformë e cila të sjellë zvogëlimin në praktikë të ngarkesës së Gjykatës së Lartë, shoqëruar kjo dhe me ndryshimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, në mënyrë që jo çdo çështje që gjykohet në shkallën e parë dhe të apelit të shqyrtohet detyrimisht edhe nga Gjykata e Lartë.



Në këtë kontekst duhet të lexohen edhe të dhënat e mësipërme pasi 93 % të çështjeve penale e masa sigurimi që janë gjykuar nga ana Gjykatës së Apelit Tiranë janë lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Lartë.

Është mëse e qartë se gjykata flet vetëm nëpërmjet vendimeve gjyqësore dhe misioni i saj është dhënia e drejtësisë. Janë pikërisht vendimet e Gjykatës së Lartë të cilat përbëjnë një nga pikat, përmes të cilave matet puna dhe cilësia e vendim-marrjes së një gjyqtari.

Cilësia e gjykimit të çështjeve penale e masa sigurimi gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, që kanë ardhur në vitin 2014 nga Gjykata e Lartë

GJYQTARE	Gjithsej	Lenie ne fuqi	Prishur	Ndryshuar
Alaudin Malaj	8	8	-	-
Fiqirete Mullaj	2	2	-	-
Shkelqim Miri	10	10	-	-
Zamir Poda	21	20	-	-
Ilir Toska	6	3	3	-
Edlira Petri	22	22	-	-
Gramoz Levanaj	16	15	1	-
Valdete Hoxha	4	3	1	-
Flutura Skenderi	10	10	1	-
Artur Kalaja	1	1	-	-
Hysni Demiraj	16	16	-	-
Zegjine Sollaku	22	22	-	-
Edmond Gogo	7	6	1	-
Gjin Gjoni	4	3	-	1
Lefter Jahaj	50	45	5	-
Metush Saraçi	33	33	-	-
Genti Shala	33	30	3	-
Astrit Haxhialushi	43	40	3	-
Fatos Qato	34	33	1	-
Evjeni Sinojmeri	1	1	-	-
Agim Bendo	9	8	-	1
Fatmira Hajdari	6	6	-	-
Ervin Metalla	3	3	-	-
Maria Qirjazi	4	4	-	-
Ridvan Hado	10	10	-	-
Shkëlqim Mustafa	1	1	-	-

Ngarkesa individuale e punës së gjyqtarëve gjatë vitit 2014

Problemet e përditshme në sistemin gjyqësor imponojnë vazhdimin e reformave në fushën e drejtësisë, si dhe ndryshime në legjislacionin aktual përmes të cilave të synohet rritja e performancës dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, duke përmirësuar shpejtësinë e gjykimit.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë edhe gjatë vitit 2014 ka qënë një qëllim strategjik reduktimi dhe barazpeshimi i ngarkesës në punë të Gjyqtarëve. Për ta parandaluar mbingarkesën dhe për t'u siguruar që Gjykata e Apelit Tiranë të jetë përherë efikase, kam bërë një grumbullim sipas kategorive të disa çështjeve dhe një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në funksion të një administrimi më të mirë të drejtësisë.

Në këtë kontekst pavarësisht objektivit strategjik ngarkesa e punës për secilin gjyqtar ka qënë relativisht e madhe. Janë gjykuar mesatarisht nga secili gjyqtar afërsisht 323 çështje civile apo penale si gjyqtar relator. Por, ka edhe gjyqtar që kanë gjykuar mbi këtë mesatare, duke patur parasysh gjyqtarët e rinj.

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mëposhtme nëse krahasojmë numrin e përgjithshëm të çështjeve që gjyqtari ka marrë pjesë në gjykim del se mesatarisht, çdo gjyqtar ka marrë pjesë në plotësim të trupave gjykues në mbi 400 çështje.

EVIDENCA E NGARKESËS INDIVIDUALE TE PUNES SË GJYQTAREVE

VJETORE 2014

EmerMbiemer	Çeshtje Si Relator	Rivend osje	Penale	Civile	Adminis trative	Urdhera Mbrojte	Kerkesa penale	Kerkesa civile
							Masesig urimi	Dh.F.V. huaja
1	2	3	4	5	6	7	8	9
AlaudinMalaj	124	18	0	45	1	0	60	1
FiqireteMullaj	353	67	2	221	5	0	50	13
ShkelqimMiri	372	66	29	205	3	2	73	9
IlirToska	441	60	1	220	1	0	151	18
Edlira Petri	414	68	0	232	2	2	112	9

ValdeteHoxha	299	43	30	187	3	0	40	5
MetushSaraci	354	60	0	185	3	1	97	21
HysniDemeraj	386	65	1	235	2	0	81	13
GjinGjoni	204	22	0	172	9	3	0	10
FluturaSkenderi	352	65	1	202	7	1	84	9
Artur Kalaja	322	55	1	205	2	2	65	6
Ervin Metalla	318	56	3	175	2	1	87	9
AgimBendo	301	61	0	168	3	3	77	6
ZegjineSollaku	421	46	3	212	4	1	154	6
ZamirPoda	371	53	1	242	2	1	73	13
GramozLevanaj	343	70	3	190	1	1	77	13
FatmiraHajdari	302	63	1	176	2	1	50	12
Edmond Gogo	326	64	3	192	4	4	66	11
RidvanHado	292	75	0	164	1	2	57	8
Marie Qirjazi	314	66	2	167	2	2	74	15
EvgjeniSinojmeri	365	68	2	229	4	1	54	12
LefterJahaj	285	0	249	1	0	0	35	0
GentiShala	269	0	239	0	0	0	30	0
Shkelqim Mustafa	247	0	220	0	0	0	27	0
FatosQato	295	1	249	0	0	0	45	0
AstritHaxhialushi	174	0	147	0	0	0	27	0
Gjithsej	8398	1127	1188	4027	63	28	1746	219

Shpejtësia në Gjykim

Sic mund të vihet re lehtësisht numri i çështjeve që i paraqiten për shqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë ka pësuar dhe vijon të pësojë një rritje të vazhdueshme. Nga ana tjetër, ky realitet kërkon njëkohësisht më shumë kujdes, më shumë kohë dhe shpenzime për zhvillimin e procesit gjyqësor. Jemi dëshmitarë të pritshmërive të lidhur me shpejtësinë e gjyimit në gjykatat tona. Sot debatohet lidhur me shkallën e respektimit të afatit të arsyeshëm në gjykimin dhe zgjidhjen e çështjeve gjyqësore. Është një shqetësim i drejtë prandaj edhe shpejtësia e gjyimit ka qënë një prioritet i Gjykatës së Apelit Tiranë gjatë vitit 2014.


Ngarkesa e madhe e punës sigurisht që përbën një problem serioz për gjykatat dhe gjyqtarët dhe duket se ka ndikimin e saj në zgjatjen e kohës së nevojshme për shqyrtimin e çështjeve. Nisur nga kjo ngarkesë pune, për garantimin e cilësisë dhe shpejtësisë së gjyimit, sfida jonë ka qënë ajo e lehtësimit të ngarkesës së gjyqtarëve nëpërmjet mekanizmave më efektive të mirëorganizimit të gjykatës.

Drejtësi e vonuar, drejtësi e munguar. Megjithatë, jam i mendimit se, nevoja për të përmirësuar shpejtësinë e gjyimit, nuk duhet të anashkalojë garantimin e cilësisë në dhënien e drejtësisë.

Sipas të dhënave statistikore të mëposhtme rezulton se shpejtësia në gjykim gjatë vitit 2014 është në tregues të mirë. Por, ka dhe çështje që janë shqyrtuar në afate kohore mbi dy muaj dhe janë kryesisht ato çështje në të cilat është përsëritur hetimi gjyqësor. Sidoqoftë duhet mbajtur parasysh fakti që shpejtësia e gjykimit për gjyqtarin llogaritet që nga momenti i shpalljes së çështjes për gjykim.

Shpejtësia në gjykimin e çështjeve:

Kohëzgjatja	Çështje Civile	Çështje Penale
Deri në 2 muaj	222	72
2 muaj deri 6 muaj	1395	704
mbi 6 muaj	2409	412



Zvarritja e qëllimshme e proceseve gjyqësore është një praktikë që krijon pasoja negative dhe shpenzime për palët, si dhe shpenzime për sistemin gjyqësor.

Proceset e zgjatura gjyqësore kanë ndikim negativ edhe në besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit Tiranë ka marrë masa praktike për të trajtuar vonesat e pajustificuara gjatë proceseve gjyqësore.

Në njërën anë, rritja e përpjekjeve për të siguruar pjesëmarrjen në kohë të të gjithë personave të përfshirë mund të kërkojë më shumë shpenzime, por nga ana tjetër

procese gjyqësore më të shkurtra e më efikase i ulnin shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme për të gjithë.

Përmbledhje e çështjeve të mbartura nga viti 2013 në vitin 2014

- 2573 Çështje civile
- 1439 Çështje penale
- 541 Çështje Civile (pezullim, rivendosje, sigurim padie)
- 3 Çështje Administrative
- 21 Çështje Dhenie Fuqi vendimi të huaj
- 12 Çështje Masa Sigurimi

Administrimi i buxhetit të Gjykatës së Apelit Tiranë

Aktiviteti i Gjykatës financohet totalisht nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimit gjyqësor derdhen në buxhet. Ky institucion mban dhe ruan në përputhje me legjislacionin shqiptar, dokumentacion me aktivitet të shërbimit gjyqësor civile, penale, të aktivitetit ekonomik, të pasurisë publike dhe marrdhënieve të punës.

Dega e Buxhetit në Gjykatën e Apelit Tiranë për vitin 2014 është orientuar drejt ndërmarrjes së hapave për përmirësimin e sistemit të **Planifikimit** dhe **Manaxhimit** të fondit buxhetor në funksion të Zhvillimit të proceseve gjyqësore, dhe rritjes së cilësive të shërbimit ndaj publikut me qëllim rritjen e standarteve bashkohore, ku konsiston si më poshtë:

-**Hartimi i Projekt –Buxhetit** afatmesëm duke u mbështetur në nevojat e domosdoshme që kjo Gjykatë të arrijë dhe të plotësojë misionin e vet në të gjitha aspektet si në cilësi dhe transparencë të plotë.

-**Ndarja e buxhetit** të planifikuar për vitin kalendarik 2014 me zërat dhe nënzërat e tij në muaj dhe tremujor është bërë sipas prioriteteve dhe nevojave të domosdoshme që i gjithë procesi të zhvillohet në harmoni dhe normalisht.

-**Menaxhimi i buxhetit** është bërë në respektim të plotë të ligjit nr.10296 datë 8.07.2010 (Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin), si dhe Udhëzimi nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimet përkatëse të ardhura nëpërmjet Z.A.B.GJ. si zyrë mbikqyrëse ndaj zbatimit të buxhetit tonë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Më poshtë paraqitet një analizë e hollësishme dhe në detaje për të gjithë zërat e buxhetit për vitin 2014 i përbërë nga katër zëra:

1-Fondi i pagave të personelit(Artikulli 600) i planifikuar sipas organikes së Gjykatës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë nr.153/2 datë 12.03.2014 të planifikuar prej 81 punonjës, dhe ku fakti për vitin 2014 është 76 punonjës me mungesë 5 Gjyqtarë. Fond i cili është shpërndarë sipas ndryshimeve ligjore ardhur në dinamikë për çdo vit kalendarik.

Realizimi i shprehur në përqindje 93.6 %

2-Fondi për shpenzimet operative (Artikulli 602) i ndarë në zërat :

-**Materiale dhe shërbime zyre** si letër, shtypshkrime, tonera, kancelari, karburant, materiale rutine të çastit emergjent.

-**Shërbime** si Energji ,Uji ,Telefona , Posta

-**Shpenzime transporti** si pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje automjesh.

-**Shpenzime të tjera speciale** si Shërbim ruajtje me roje civile, Shërbim Avokatie, Ekzekutime vendime gjyqësore. Të shprehur në vlerë:

Realizimi i shprehur në përqindje në masën 97.9 %

3-Fondi për Investime (Artikulli 231) i përbërë në zërat:

Blerje set zyre për dhoma këshillimi në sallat e gjyqëve dhe librari ligjore në ambientet e qëndrimit të publikut.

Rrugica për shkallët dhe korridore të godinës

Ky realizim është i shprehur në përqindje në masën 98.9 %

Duke analizuar shpenzimet buxhetore në veprimtarinë e gjykatës theksoj se fondi buxhetor i akorduar për vitin -2014 është realizuar në harmoni me kërkesat dhe nevojat e domosdoshme për realizimin me sukses të misionit të kësaj Gjykate në transparencë dhe korrektesë ligjore.

4-Realizimi i të ardhurave për vitin 2014 konsiston në zërat si më poshtë;

-**Qera ambjenti** e cila arketohet 100% në buxhetin e Shtetit

-**Të ardhurat nga Taksa e Pullave** e cila është derdhur në masën 100 %, për llogari të Degës së Tatim Taksave.

Për një performancë më të mirë të manaxhimit dhe zbatimit të buxhetit në mënyrë rigorozë dhe i dokumentuar me dokumentet standarte financiare dhe kontabel sipas

Udhëzimeve të Ministrisë së Financave, i fundit nr.2 datë 06.02.2012 (Për Procedurat Standarte të zbatimit të buxhetit),

Duke analizuar ndikimin e buxhetit në veprimtarinë e kësaj periudhe kemi orientuar idetë për planifikimin e buxhetit për vitin 2016 duke rritur performancën në zbatimin korrekt të zërave të buxhetit në kryejën e detyrave të misionit.

Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit është bërë në mënyrë rigoroze dhe i dokumentuar me dokumentet standarte financiare dhe kontable sipas Udhëzimeve të Ministrisë Financave. Dega e Buxhetit përgatit çdo muaj azhurnimin e dokumentacionit ekonomik financiar dhe kontabël duke dhënë informacionin në mënyrë shkresore sipas detyrimit ligjor si më poshtë :

- 1- Nënpunësit Autorizues(Kryetari i Gjykatës)
- 2- Z.A.B.GJ
- 3- Dega e Thesarit
- 4- Ministria e Drejtësisë
- 5- Dega Tatim TaksaveTiranë (taksën e pullave)
- 6- Ministrisë Ekonomisë (Qera Ambjenti)

Realizimi i Buxhetit në shifra konkrete sipas zërave në total rezulton si më poshtë:

	Artikulli	Plan/lekë	Fakt/lekë	Diferenca/lekë	Realizimi në %
Paga	600	84,600,000	79,167,739	5,432,261	93.58
Siguracione Shoq Shendetsore	601	11,700,000	10,916,165	783,835	93.30
Sh.operative	602	19,078,179	18,671,976	406,203	97.87
Ndihma	606	90,000	90,000	0	100.00
Investime	231	2,240,000	2,216,040	23,960	98.93
	Totali	117,708,179	111,061,920	6,646,259	94.35
Nga të Ardhurat e 10% të taksës së pullës		1459	1459	0	100.00
Garanci punimesh	4662100	341756	341756	0	100
Garanci pasurore	4665100	800000	0	800,000	
Qera mujore nga lokali në institucion	7109600	138600	138600	0	100

Aktivitete të zhvilluara gjatë vitit 2014

Gjykata e Apelit Tiranë në praktikën e saj ka konsoliduar mbledhjen periodike të mëngjesit me të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate ku diskutohen ndër të tjera edhe vendimet e Gjykatës së Lartë mbi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit si dhe diskutime lidhur me vendimet unifikuese.

Në zbatim të vendimit të KLD, në Gjykatën e Apelit Tiranë është drejt përfundimit mbledhja e të dhënave statistikore lidhur me procesin e vlerësimit të Gjyqtarëve për periudhën e caktuar nga KLD, 2007-2009. Lidhur me këtë çështje është konstatuar se ka mangësi të theksuara të të dhënave në regjistrat e mbajtur nga Kryesekretaria e Gjykatës për atë periudhë kohore. Kryetari i Gjykatës i ka bërë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë dhe kompanisë që mirëmban këtë sistem, që të merren masa që në sistemin ICMIS të gjenerohen dhëna statistikore në përputhje me tabelat e kërkuara nga KLD për vlerësimin e gjyqtarëve.

Ne date 20.12.2014 ne ambientet e Gjykatës se Apelit Tirane u zhvillua faza e II e konkursit “Simulimi i gjyqeve te Gjykates Europiane te te drejtave te njeriut Shqiperi 2015” projekt i realizuar nga Qendra Europiane ne bashkepunim me Civil Rights Defenders. Gjashtë universitete të drejtësisë në vend, të përzgjedhura në bazë të një rregullorje dhe kriterëve të mirëpërcaktuara u “përballën” me njëri-tjetrin. Studentët pjesëmarrës në këtë konkurs patën mundësinë të venë në praktikë dhe të thellojnë më tej njohuritë e tyre në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre të drejtave, që garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe u njohën më mirë të funksionimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Në vijim të këtij bashkëpunimi me Qendrën Evropiane, është hartuar një fletëpalosje informuese dhe orientuese e cila është vënë në dispozicion të frekuentuesve të gjykatës, në cdo ambient të gjykatës, me qëllim informimin sa më mirë të publikut me veprimtarinë e gjykatës dhe me qëllim rritjen e transparencës. Ky informacion është i mundshëm edhe në faqen e internetit të gjykatës.

Më datë 17 dhjetor 2014, Z. Truman A. Morrison, gjyqtar me përvojë nga Gjykata Superiore e Distriktit të Kolumbias në kryeqytetin e SHBA-së, së bashku me Z. John Carver, Drejtor i Projektit JuST të USAID-it dhe Znj. Fiorentina Azizi, Shefe e Departamentit të Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri zhvilluan një takim me Kryetarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, Z. Alaudin Malaj dhe gjyqtarët e kësaj gjykate. Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohej mbi rolin e Gjykatës së Apelit në rishikimin e vendimmarrjes në shkallën e parë, sidomos në kuadër të projektit për një drejtësi pa vonesa.

Përpara këtij takimi, Gjyqtari Morrison u kishte shpërndarë të gjithë gjyqtarëve të kësaj gjykate një material ku kishte shprehur mendimet e tij lidhur me këtë çështje (materiali në fjalë i është bashkëlidhur këtij përshkrimi të shkurtër të takimit). Gjyqtarët diskutuan me Gjyqtarin Morrison dhe ndanë me të këndvështrimet e tyre mbi mënyrat se si Gjykata e Apelit Tiranë mund të kontribuojë për të mbështetur gjykatat e shkallës së parë në punën e tyre për dhënien e drejtësisë brenda afateve të arsyeshme kohore.

Ky takim u realizua para Konferencës së Liderimit të Gjyqësorit për një Drejtësi pa Vonesa, e cila u zhvillua në Tiranë, më datë 19 dhjetor 2014, me pjesëmarrjen e të gjithë kryetarëve të gjykatave të Shqipërisë, me synimin për të ndarë së bashku praktikat më të mira dhe inkurajuar gjykatat e tjera në përballjen me sfidën e përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve, përmes adoptimit të “technikave për menaxhimin aktiv të çështjeve gjyqësore”.

Më datë 30.04.2014 – Prezantim i sistemit dixhital audio në ambientet e Gjykatës së Apelit Tiranë nga projekti JUST, në bashkëpunim me Qendrën ALTRI.

Më datë 17.04.2014 është organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Fondacionin Slynn, trajnimi me teme “Etika Gjyqësore”, në të cilin morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

* * *

Gjykata e Apelit Tiranë është mjaft e interesuar lidhur me nivelin e kënaqësisë së qytetarëve ndaj shërbimeve gjyqësore. Për këtë qëllim është hartuar një pyetësor i cili do të plotësohet nga frekuentuesit e Gjykatës së Apelit Tiranë. Metoda e zgjedhur i mundëson gjykatës të marrë një informacion të drejtpërdrejtëmbi cilësinë e shërbimit që i ofrohet qytetarëve nga gjykata.

Gjithashtu do të vijohet me hartimin e pyetësorëve të tjerë dhe monitorimin konstant të nivelit të kënaqësisë së qytetarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, pa cenuar kurrësi vendimmarrjen e gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Ju faleminderit për vëmendjen!

**Kryetari i Gjykatës
ALAUDIN MALAJ**